



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1387 prot.

Tepelenë, më 04.08.2025

V E N D I M

Nr. 44, datë 31.07.2025

“PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT : NDËRTIMI I INFO-POINT, VENDPARKIMI DHE AKSESIT TË RRUGËS NË PARKIM” SI PROJEKT PRIORITAR

Këshilli i Bashkisë Tepelenë, në mbledhjen e datës 31.07.2025, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, në mbështetje të nenit 64 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Urdhrit nr. 168, datë 08.11.2024, termave të referencës nr. 1857/1, datë 11.11.2024, si dhe projektit të dorëzuar me nr. prot. 536/5, datë 20.06.2025, dhe bazuar në analizën e dokumentacionit nga grupi i punës,

V E N D O S I:

1. Të miratojë projektin: “Ndërtimi i info-point, vendparkimi dhe aksesit të rrugës në parkim”, si projekt prioritar për Bashkinë Tepelenë.
2. Të ngarkojë Drejtorinë e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor ga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

ARBEN GUMENI

Miratuar me 9 (nëntë) vota
Vota Pro 9 (nëntë)vota
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur më datë 04.08.2025

